



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR VLORE

| | | | |
|------------------|---------------------|---------------------|-----------|
| Numri i Çështjes | 71108-00996-61-2017 | Data e Regjistrimit | 7/17/2017 |
| Numri i Vendimit | 61-2017-4365 | Data e Vendimit | 10/5/2017 |

VENDIM
NE EMER TE REPUBLIKËS

GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR VLORE E PERBERE NGA:

KRYESUES: Atalanta Zeqiraj

ANËTAR

SEKRETARE Blerina Braka

Objekti: Gjykimi i procedimit penal me nr 1128 e vitit 2017 ne ngarkim te pandehurit Mihal Kokedhima , akuzuar per kryerjen e vepres penale te "Ndertim te paligjshem " te parashikuar nga neni 199/a/2 i K.Penal

Baza Ligjore : Ndertim te paligjshem - Neni 199/a/2 i Kodit Penal

Përmbledhja e vendimit:

<?xml:namespace prefix = "o" ns = "urn:schemas-microsoft-com:office:office" />

Në përfundim të shqyrtimit gjyqësor, gjykata, pasi administroi provat e ndodhura në fashikullin e procedimit penal Nr.1128 të vitit 2017 dhe pasi dëgjoi konkluzionet përfundimtare të palëve, të cilët kërkuan:

Prokuroria Znj. Eranda Laze kërkoj:

1. *Deklarimin fajtor të të pandehurit Mihal Kokedhima për veprën penale "Ndërtim i paligjshëm" e parashikuar nga neni 199/a/2 i Kodit Penal dhe dënimin e tij me 1 vit burgim.*
2. *Në bazë të nenit 59 të Kodit Penal të pezullohet ekzekutimi i dënimit me burgim duke urdhëruar të pandehurin të mbaj kontakte me shërbimin e provës dhe të vihet në provë për një afat 1 vit e gjashtë muaj.*
3. *Shpenzimet procedurale të kryera gjatë hetimeve paraprake t'i ngarkohen të pandehurit.*

Si dhe pasi e shqyrtoi çështjen në tërësi,

Vëren:

VËREN SE:<?xml:namespace prefix = "o" ns = "urn:schemas-microsoft-com:office:office" />

1. Procedura:

1. Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Vlorë ka sjellë për gjykim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë çështjen penale në ngarkim të pandehurit x i akuzuar për kryerjen e veprës penale "Ndërtim i paligjshëm", të parashikuar nga neni 199/a paragrafi i dytë i K.Penal.

2. Fillimisht gjykata mori në shqyrtim juridiksionin dhe kompetencën për gjykimin e kësaj çështje penale. Bazuar në nenet 69/1, 74 dhe 76 të K.Pr.Penale shqyrtimi i kësaj çështje



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR VLORË

penale, hyn në juridiksionin gjyqësor dhe kompetente nga pikëpamja lëndore dhe tokësore për shqyrtimin e saj është Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë. Kështu, sipas nenit 74 të K.Pr.Penale: *“Gjykata e Rrethit Gjyqësor është kompetente për gjykimin e veprave penale, përveç atyre që i përkasin kompetencës së gjykatës për krime të rënda, gjykatës ushtarake dhe Gjykatës së Lartë.”* Sipas kësaj dispozite, vepra penale, objekt gjykimi, nuk është në kompetencën lëndore as të Gjykatës së Krimeve të Rënda, as të Gjykatës Ushtarake dhe as të Gjykatës së Lartë. Si rrjedhojë, kjo Gjykatë konstaton se ka kompetencë lëndore për shqyrtimin e çështjes penale objekt gjykimi. Ndërsa në lidhje me kompetencën tokësore, i referohemi nenit 76 të K.Pr.Penale që parashikon: *“Kompetenca tokësore përcaktohet, me radhë, nga vendi ku është kryer ose është tentuar të kryhet vepra penale ose vendi ku ka ardhur pasoja.”* Në rastin konkret konstatohet se veprat penale për të cilat akuzohet i pandehuri ka ndodhur në Himarë, Vlorë. Në këto kushte, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë është kompetente për shqyrtimin e kësaj çështje penale.

3. Bazuar në nenin 13/3 të K.Pr.Penale që parashikon: *“Gjykatat e rretheve gjyqësore gjykojnë me një gjyqtar veprat penale, për të cilat parashikohet dënimi me gjobë ose me burgim në maksimum jo më shumë se 7 vjet. Veprat e tjera penale gjykohen me trup gjykues të përbërë nga tre gjyqtarë”,* gjykimi i kësaj çështje penale u zhvillua me trup gjykues të përbërë nga një gjyqtarë.

4. Në fazën procedurale të parashtrimit të kërkesave paraprake në kuptim të nenit 354 të K.Pr.Penale dhe të kërkesave të tjera përpara fillimit të shqyrtimit gjyqësor, i pandehuri në bazë të nenit 403 të K.Pr.Penale, kërkoj që të procedohet me gjykim të shkurtuar. Duke qenë se neni 403 i K.Pr.Penale parashikon se një kërkesë të tillë mund ta bëjë i pandehuri ose përfaqësuesi i tij i posaçëm, vetë i pandehuri i pranishëm në seancë kërkoj që të procedohet me gjykim të shkurtuar.

5. Gjykata, para marrjes së vendimit në lidhje me këtë kërkesë, dëgjoi edhe mendimin e prokurores e cila u shpreh se ishte dakord me këtë kërkesë, duke qenë se çështja mund të zgjidhet në gjendjen që janë aktet. Gjithashtu, gjykata pas shqyrtimit me imtësi të të gjitha akteve të ndodhura në fashikullin e gjykimit, ku konstatoi se ato nuk përmbanin ndonjë pavlefshmëri nga ato të parashikuara në nenin 128 të K.Pr.Penale, vlerësoi se bazuar në nenin 404 të K.Pr.Penale, ka vend për të proceduar me gjykim të shkurtuar, duke çmuar në këtë mënyrë se çështja mund të zgjidhet në gjendjen që janë aktet. Kështu, bazuar në nenin 404 të K.Pr.Penale dhe Vendimin Unifikues Nr.2, datë 29.01.2003 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, si dhe vendimet Nr.4 datë 10.02.2012 dhe Nr.24, datë 30.04.2012 të Gjykatës Kushtetuese, Gjykata vendosi të pranojë kërkesën e të pandehurit dhe të procedojë me gjykim të shkurtuar.

6. Në marrjen e këtij vendimi, gjykata mbajti parasysh kriteret nga të cilat duhet të udhëhiqen gjykatat për të vendosur pranimin e kërkesës së të pandehurit për gjykim të shkurtuar mbi të cilat janë shprehur dhe Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë në vendimin unifikues të sipërcituar, duke çmuar se çështja mund të zgjidhet në gjendjen në të cilën ndodhen aktet pa qenë e nevojshme që ato t'i nënshtrohen shqyrtimit gjyqësor, kjo duke patur parasysh faktin se, ashtu siç janë shprehur Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, në Vendimin Unifikues Nr. 2 të vitit 2003:

«Gjykimi i shkurtuar, si gjykim i posaçëm, në thelb të tij ka pranimin e akteve të grumbulluara gjatë fazës së hetimit paraprak dhe eviton marrjen e provave në seancë gjyqësore dhe debatin lidhur me to. Ky gjykim eviton fazën e hetimit gjyqësor... Me pranimin e kërkesës për të vazhduar me gjykim të shkurtuar, dosja e prokurorit kthehet në dosje gjyqësore dhe shërben për t'u bazuar në parashtrimin e konkluzioneve përfundimtare të palëve dhe për dhënien e vendimit nga gjykata”.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR VLORË

7. Gjithashtu në marrjen e këtij vendimi, gjykata mbajti parasysh edhe faktin se gjykimi i shkurtuar ka vlerë për ekonomi gjyqësore sepse thjeshton dhe shkurton procedurat, rrit shpejtësinë dhe efektivitetin e gjykimit dhe sjell si pasojë një përfitim për të pandehurin në uljen e 1/3 së masës së dënimit dhe mos aplikimin e dënimit me burgim të përjetshëm. Gjkata në këtë rast i referohet edhe vendimit Nr.24, të datës 30.04.2012 të Gjykatës Kushtetuese e cila shprehet se: *“Në rastin objekt shqyrtimi, Gjkata, duke u bazuar në vlerësimet e lartpërmendura, vëren se kërkuesi, duke marrë në konsideratë kualifikimin e veprës penale të “vjedhjes me dhunë”, të kryer nga prokurori, si dhe duke vlerësuar dënimin e parashikuar për këtë veprë penale (në rast të deklarimit fajtor të tij nga gjykata), ka kërkuar të procedohet me gjykim të shkurtuar, në gjendjen që janë aktet, në lidhje me këtë veprë penale, duke hequr dorë kështu në mënyrë të vullnetshme nga disa të drejta kushtetuese (si parimi i barazisë së armëve dhe i formimit të provës në kontradiktoritet) në gjykim në mënyrë që të përfitojë nga avantazhet (ulja e dënimit) e përcaktuara nga legjislatori për këtë qëllim; ndërsa gjykatat e juridiksionit të zakonshëm edhe pse kanë pranuar kërkesën e kërkuesit për të proceduar me gjykim të shkurtuar në lidhje me veprën penale të “vjedhjes me dhunë”, e kanë deklaruar fajtor dhe dënuar për një veprë penale të re, më të rëndë, atë të “vjedhjes me pasojë vdekjen” duke i cenuar kështu kërkuesit të drejtën e mbrojtjes në lidhje me veprën për të cilën është deklaruar fajtor... Bazuar në këto vlerësime, Gjkata rithekson se gjyqtari në momentin e marrjes së vendimit, në lidhje me pranimin ose jo të kërkesës për gjykim të shkurtuar të të pandehurit, duhet të udhëhiqet jo vetëm nga parimi i ekonomisë gjyqësore (shih paragrafin 15 të këtij vendimi), por duhet të vendosë, kryesisht, në përputhje me parimin e drejtësisë efektive. Kjo do të thotë që ai, ndër të tjera, duhet të marrë në konsideratë edhe cilësimin juridik të veprës penale të përcaktuar nga prokurori (shih vendimin nr.4, datë 10.02.2012 të Gjykatës Kushtetuese).”*

8. Duke qenë se kërkesa për gjykim të shkurtuar u pranua nga gjykata, gjatë gjykimit u respektuan kërkesat procedurale të gjykimit të shkurtuar, të sanksionuar në K.Pr.Penale. Kështu, duke pasur parasysh se gjykimi i shkurtuar, si gjykim i posaçëm, eviton fazën e hetimit gjyqësor dhe në thelb të tij ka pranimin e akteve të grumbulluara gjatë fazës së hetimit paraprak duke evituar marrjen e provave në seancë gjyqësore dhe debatin lidhur me to, dosja e prokurorit u kthye në dosje gjyqësore dhe shërbeu për t'u bazuar në parashtrimin e konkluzioneve përfundimtare të palëve dhe për dhënien e vendimit nga gjykata. Gjykimi penal u zhvillua vetëm mbi bazën e provave të siguruara gjatë fazës së hetimeve paraprake, të cilat nuk iu nënshtruan debatit gjyqësor dhe nuk u administruan gjatë gjykimit prova të reja.

II. Rrethanat e faktit:

9. I pandehuri Mihal Kokëdhima është administrator i lokalit “Panorama” që ndodhet në vendin e quajtur “Porto Palermo” Himarë. Më datë 26.06.2017 oficerë të policisë gjyqësore të Stacionit të Policisë Himarë janë njoftuar se në afërsi të këtij lokali po kryhej një ndërtim pa leje. Policia gjyqësore ka shkuar në vendngjarje dhe ka konstatuar në anën veriore të lokalit ndërtimin e një muri me material guri me gjatësi 11 m, me gjerësi 50 cm dhe lartësi 70 cm. Në vendin ku po ndërtohej ky mur janë gjetur dy punëtorë, konkretisht shtetasit Lush Biçaku dhe Luan Kashari.

9.1 Të pyetur në cilësinë e personave që kanë dijeni për veprën penale shtetasi x dhe y ka deklaruar se disa ditë më parë janë punësuar nga nga shtetasi x për ndërtimin e murit. Në vijim ata kanë shpjeguar se e kanë pyetur “punëdhënësin” nëse ka marrë leje për kryerjen e një ndërtimi të tillë dhe x i ka siguruar që të mos shqetësoheshin pasi kishte marrë leje. Ata kanë rënë dakord edhe në lidhje me pagesën që do të kryhej në fund të punës.

10. I pyetur rreth ndërtimit të kryer i pandehuri x ka deklaruar se nuk ka marrë leje për



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR VLORE

kryerjen e një ndërtimi të tillë dhe se këtë mur e ka ndërtuar që të pengonte kalimin e bagëtisë në pronën e tij. I pyetur me cilësinë e të pandehurit shtetasi x ka deklaruar se “Lidhur me akuzën unë e pranoj dhe shpreh pendim të thellë për këtë veprim që kam kryer” (procesverbal i pyetjes së të pandehurit datë 14.07.2017).

11. Faktet e cituara më lart provohen nga këto prova:

11.1 Faktet e parashtruara më lart u provuan nga administrimi gjyqësor me cilësinë e provës të:

- Procesverbal “Për kqyrjen e vendit të ngjarjes” datë 26.06.2017, ora 10.00.
- Procesverbal “Për marrjen e të dhënave nga personi që ka dijeni për veprën penale” datë 26.06.2017.
- Procesverbal “Për marrjen e të dhënave nga personi që ka dijeni për veprën penale” datë 31.05.2017.
- Procesverbal “Për marrjen e të dhënave nga personi që ka dijeni për veprën penale” datë 30.06.2017.
- Procesverbale “I pyetjes së të pandehurit” datë 14.07.2017.
- Akti i njoftimit të akuzës dhe marrjen si të pandehur si dhe në tërësi fashikulli i procedimit penal Nr.1128 të vitit 2017.

III. Ligji i zbatueshëm:

- Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë.
 - Neni 12 i K.Penal parashikon: “*Ka përgjegjësi penale personi që në kohën e kryerjes së një krimi ka mbushur moshën katërmëdhjetë vjeç. Personi që kryen një kundërvajtje penale ka përgjegjësi kur ka mbushur moshën gjashtëmbëdhjetë vjeç.*”
 - Neni 47 i K.Penal parashikon: “*Gjykata cakton dënimin duke respektuar dispozitat e pjesës së përgjithshme të këtij kodi dhe kufijtë e dënimeve të parashikuara në ligj për veprën penale. Në caktimin e dënimit ndaj personit ajo merr parasysh rrezikshmërinë e veprës penale, të autorit të saj, shkallën e fajit si dhe rrethanat lehtësuese dhe rënduese.*”
 - Neni 199/a paragrafi i dytë parashikon: “*1.Ndërtimi i kryer pa leje, në shkelje të rëndë të lejes ose në kushtet e një lejeje të shfuqizuar në tokën në pronësi të vet, dënohet me burgim deri në një vit. 2. Po kjo vepër, e kryer në tokën publike ose shtetërore apo në tokën e tjetrit, dënohet me burgim nga një deri në pesë vjet.*”
- Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë.
 - Neni 390/1 i K.Pr.Penale parashikon: “*Kur i pandehuri del fajtor për veprën penale që i atribuohet gjykata jep vendim dënimi, duke caktuar llojin dhe masën e dënimit.*”
 - Neni 406/1 i K.Pr.Penale parashikon: “*Kur jep vendim dënimi, gjykata e ul dënimin me burgim ose gjobë me një të tretën. Dënimi me burgim të përjetshëm zëvendësohet me njëzet e pesë vjet burgim.*”



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR VLORË

➤ Vendime të Gjykatës së Lartë dhe Gjykatës Kushtetuese.

- Vendimi Unifikues Nr.2, datë 29.01.2003 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.
- Vendimi Nr.4, datë 10.02.2012 i Gjykatës Kushtetuese.
- Vendimi Nr.24, datë 30.04.2012 i Gjykatës Kushtetuese.

IV. Vlerësimi i gjykatës:

A. Përsa i përket cilësimit juridik të veprës penale:

- *Në lidhje me akuzën për kryerjen e veprës penale "Ndërtim i paligjshëm" nga shtetasi Mihal Kokëdhima:*

12. Gjykata vëren se, vepra penale për të cilën akuzohet i pandehuri është parashikuar nga K.Penal në pjesën e posaçme të tij, në Kreun II, Seksioni XI të titulluar "Vepra penale që çënojnë regjimin juridik të tokës dhe ndërtimeve". Objekt i këtyre veprave janë marrëdhëniet juridike të vendosura për të mbrojtur regjimin juridik të tokës, paprekshmërinë e saj, destinacionin e përcaktuar dhe mënyrën e menaxhimit të tokës, si dhe regjimin juridik të ndërtimeve.

13. Nga interpretimi i këtyre dispozitave rezulton se ligjvënësi, ka parashikuar një mbrojtje të posaçme juridike të marrëdhënieve, që garantojnë mbrojtjen e regjimit juridik të tokës dhe ndërtimeve të mbrojtura posaçërisht me legjislacionin penal nga veprimet ose mosveprimet kriminale. Sipas këtyre dispozitave, veprimet që çënojnë marrëdhëniet e sipërpërmendura passjellin përgjegjësi penale, sipas nenit 199/a/2 të K.Penal. Gjykata, paraprakisht evidenton faktin se për të pasur figurën e veprës penale të parashikuar nga neni 199/a/2 i K.Penal duhet të ekzistojnë njëkohësisht këto elemente:

Së pari, duhet të ekzistojë objekti i veprës penale "Ndërtim i paligjshëm", që do të thotë që i pandehuri të ketë cënuar marrëdhëniet juridike që garantojnë regjimin juridik të tokës, paprekshmërinë e saj, destinacionin e përcaktuar dhe mënyrën e menaxhimit të tokës, si dhe regjimin juridik të ndërtimeve. Në rastin konkret rezulton se i pandehuri me anë të veprimeve të tij ka cënuar pikërisht këtë marrëdhënie, duke qenë se në tokën e tjetrit ka qenë duke ndërtuar pa pasur në fakt një leje ndërtimi.

Së dyti, nga ana objektive, në kuptim të nenit 199/a/2 të Kodit Penal, figura e veprës penale "Ndërtim i paligjshëm" nga ana objektive kryhet nëpërmjet ndërtimit të paligjshëm të një objekti pa lejen e organeve kompetente, i cili duhet të ndërtohet në:

- tokën e tjetrit; dhe
- pa lejen e organeve kompetente

13.1. Kështu, nga ana objektive kjo vepër kryhet me veprime aktive që konsistojnë në kryerjen nga ana e një personi të veprimeve me karakter ndërtimor pa patur më parë lejen e organit kompetent shtetëror. Në rastin në gjykim, Gjykata çmon se nga provat që janë administruar gjatë procesit arrihet të provohet se i pandehuri nëpërmjet veprimeve aktive, ka qenë duke ndërtuar një mur me material guri me gjatësi 11 m, me gjerësi 50 cm dhe lartësi 70 cm me qëllim rrethimin e lokalit në tokën e cila sikurse pranohet prej të pandehurit nuk është e tija.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR VLORË

Tjetër kusht që duhet të plotësohet në mënyrë që nga ana objektive të ndodhemi para veprës penale të parashikuar nga neni 199/a/2 të K.Penal duhet që ndërtimi të bëhet pa leje, pra të mos ketë leje ndërtimi. Në rastin konkret, rezultojnë se plotësohet edhe ky kusht, pra i pandehuri ka pranuar dhe ka rezultuar se në fakt ai nuk ka pasur një leje ndërtimi për ndërtimin e murit që ka qenë duke kryer. Gjithashtu, duhet të mbahet parasysh se neni 199/a i Kodit Penal është një dispozitë blankete, që të referon në akte të tjera ligjore ose nënligjore, të cilat rregullojnë ndërtimin e banesave dhe objekteve të tjera në Republikën e Shqipërisë, të cilave ligji u ka dhënë një mbrojtje të posaçme juridike. Kështu, koncepti i ndërtimit pa leje jepet në Ligjin Nr.9482, datë 3.4.2006 "Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje", i ndryshuar. Në nenin 3, nën titullin "Përkufizime" të këtij ligji, parashikohet shprehimisht se: "...a) *"Ndërtim pa leje"* është objekti, për të cilin është përfunduar konstruksioni dhe mbulesa, i destinuar për banim, veprimtari ekonomike dhe/ose funksione të tjera (si për shembull, social-kulturor, arsim, shëndetësi e të tjera të këtij lloji), për të cilin nuk janë respektuar procedurat e përcaktuara në ligjin nr. 8405, datë 17.9.1998 "Për urbanistikën". Në ndërtimet pa leje bëjnë pjesë edhe tejkalimet dhe shtesat informale të objekteve të ndërtuara me leje brenda vendbanimeve formale nga subjekte, persona fizikë dhe juridikë, privatë, për qëllime shitblerjeje/qiradhënieje (banesa, zyra, dyqane, punishte, parkim etj.) ose për vete.". Kjo dispozitë ligjore e lidh ndërtimin pa leje me mosrespektimin e procedurave të parashikuara në Ligjin Nr.8405, datë 17.9.1998 "Për urbanistikën", i ndryshuar. Në nenin 45 të këtij ligji parashikohet shprehimisht se: "Çdo person fizik e juridik, vendas ose i huaj që do të ndërtojë në territorin e Republikës së Shqipërisë duhet të pajiset me leje ndërtimi. Ky është dokumentacioni i vetëm ligjor mbi bazën e të cilit lejohet ndërtimi. Leja e ndërtimit i jepet personit juridik ndërtues të licencuar." Ligji Nr.8405, datë 17.9.1998 "Për urbanistikën", i ndryshuar i ka pushuar efektin e tij më datë 30 shtator 2011 me fillimin e efekteve të plota të Ligjit Nr. 10 119 datë 23 Prill 2009 "Për planifikimin e territorit"^[1]. Në nenin 71 të këtij ligji parashikohet shprehimisht se: "1. Çdo person fizik ose juridik, vendas apo i huaj, që synon të kryejë një zhvillim të ri në Republikën e Shqipërisë, në territore në pronësi të tij ose në pronësi private apo publike, për të cilat ai gëzon të drejta ligjore, në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, duhet të pajiset me leje zhvillimi, në përputhje me përcaktimet e këtij kreu dhe me instrumentet kombëtare e vendore në fuqi të planifikimit dhe të kontrollit të zhvillimit, për çdo zhvillim të tokës ose të strukturave në të apo për kryerje të punimeve për zhvillimin e tyre, përveç rasteve kur kjo gjë përjashtohet sipas këtij ligji.". Ligji Nr. 10 119 datë 23 Prill 2009 "Për planifikimin e territorit" i ka pushuar efektet më datë 01.10.2014 me hyrjen në fuqi të Ligjit Nr.107/2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", ku në nenin 39 të këtij ligji nën titullin "Leja e ndërtimit" parashikohet shprehimisht se: "1. Leja e ndërtimit është e nevojshme për çdo ndërtim, riparim, restaurim apo prishje të objekteve ekzistuese, instalim apo ngritje të ndërtimeve të përkohshme, me përjashtim të rasteve të parashikuara nga neni 41 i këtij ligji...", ndërsa në nenin 41 të këtij ligji është parashikuar: "1. Rregullorja e zhvillimit përcakton listën e ndërtimeve, instalimeve dhe punimeve që, për shkak të ndërhyrjeve jothelbësore në objekt, natyrës së përkohshme së instalimeve ose rregullimit të kontrollit të zhvillimit nga një leje apo autorizim tjetër apo nga legjislacioni i posaçëm sektorial, nuk kërkojnë pajisjen me një leje ndërtimi dhe janë objekt i një deklaratë paraprake për kryerje punimesh...". Nga përmbajtja e këtyre dispozitave rezultojnë se, që një ndërtim të konsiderohet i ligjshëm, duhet patjetër të shoqërohet me lejen e organeve kompetente, që me ligjin në fuqi jepet nga kryetari i bashkisë ose komunës. Në kundërt ai konsiderohet i paligjshëm. Në pikën 115 të Rregullores Urbanistike miratuar me Vendimin Nr. 722, datë 19.11.1998 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e Rregullores së Urbanistikës", i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: "115. Objekt ose ndërtim do të quhet çdo masë që formon vëllimin ose sipërfaqe ndërtimore, e cila krijon hije dhe ngrihet në lartësi, përveç pemëve ose gjelbërimeve të larta.", ndërsa në pikën 116 të kësaj rregulloreje thuhet se: "116. Në objekte përfshihen ndërtesa, mure, mure rrethuese, ndërtime të përkohshme, ndërtime transparente, reklama dhe që qëndrojnë në lartësi mbi 1.8 m.". Nga përmbajtja e këtyre dispozitave rezultojnë se, që një punim ndërtimor të konsiderohet objekt,



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR VLORE

duhet që të ngrihet në lartësi mbi 1.8 metra, pavarësisht faktit nëse është ndërtesë, mur, ndërtim i përkohshëm, ndërtim transparent apo reklama. Me ndryshimet e bëra në Kodin Penal dhe konkretisht të nenit 199/a, ku thuhet se: “*Ndërtimi i kryer pa leje, në shkelje të rëndë të lejes ose në kushtet e një lejeje të shfuqizuar në tokën në pronësi të vet, dënohet me burgim deri në një vit.*”, legjislatori ka dashur të tregojë se tashmë veprë penale nuk do të konsiderohet ndërtimi i një objekti ndërtimor (që duhet të jetë mbi 1.8 metra i lartë) por çdo lloj ndërtimi për të cilin kërkohet leje ndërtimi ose zhvillimi, pavarësisht nga lartësia, pasi në të kundërt nuk do ta ndryshonte dispozitën nga “*Ndërtimi i paligjshëm i një objekti*” me “*ndërtim i kryer pa leje*”. Në rastin konkret, i pandehuri më datë 26.06.2017 ka qenë duke ndërtuar një mur me material guri me gjatësi 11 m, me gjerësi 50 cm dhe lartësi 70 cm në tokën e tjetrit në kushtet kur nuk ka qenë i pajisur me leje. Pra, duhet të mbahet parasysh, ashtu siç u tha më lart, se me ndryshimet e bëra në fillim të vitit 2015, tashmë sipas nenit 199/a të K.Penal konsiderohet si veprë penale çdo lloj ndërtimi për të cilin kërkohet leje ndërtimi ose zhvillimi. Në këtë mënyrë, me anë të provave të administruara në gjykim, provohet se nga ana objektive ndodhemi para veprës penale të parashikuar nga neni 199/a/1 i K.Penal.

Së treti, i pandehuri duhet të plotësojë kushtet për t’u konsideruar subjekt i veprës penale. Subjekti i veprës penale quhet personi që ka mbushur moshën e caktuar me ligj për përgjegjësi penale dhe që është i përgjegjshëm. Kështu, në rastin e veprës penale të parashikuar nga neni 199/a/2 i K.Penal, sipas nenit 12 të K.Penal duhet të jetë 14 vjeç dhe jetë i përgjegjshëm. I pandehuri Mihal Kokëdhima i plotëson të dyja këto kushte për t’u konsideruar subjekt i veprës penale: ai ka qenë dhe është i përgjegjshëm si dhe ka mbushur moshën për përgjegjësi penale. Në këto kushte, i pandehuri është subjekt i veprës penale të parashikuar nga neni 199/a/2 të K.Penal.

Së katërti, duhet të ekzistojë edhe ana subjektive, që është një element kryesor dhe i domosdoshëm i figurës së veprës penale, e cila përfaqëson pjesën e brendshme të saj. Kështu, kur flasim për anën subjektive i referohemi fajit, motivit dhe qëllimit. Në rastin konkret, veprimet e të pandehurit duhet të jenë kryer me dashje të drejtëpërdrejtë. Kështu, në plotësim të këtij elementi gjykata çmon se i pandehuri, ka vepruar me dashje të drejtëpërdrejtë, pasi ajo ka parashikuar karakterin shoqërisht të rrezikshëm të veprimeve të saj dhe ka vepruar në mënyrë të kundërligjshme e të vullnetshme, duke ndërtuar në mënyrë të paligjshme, pa u pajisur me leje ndërtimi.

Sa më sipër u arsyetua, Gjykata arrin në përfundimin se i pandehuri x , duhet të deklarohet fajtor për veprën penale të “*Ndërtim i paligjshëm*”, parashikuar nga neni 199/a/2 i Kodit Penal.

B. Përsa i përket llojit dhe masës së dënimit:

14. Parimet dhe kriteret e përgjithshme të caktimit të dënimit janë përcaktuar në nenin 1/c të K.Penal, i cili parashikon se “*Kodi penal bazohet në parimet kushtetuese të shtetit të së drejtës, të barazisë përpara ligjit, të drejtësisë në caktimin e fajësisë dhe të dënimit, si dhe të humanizmit.*” Në këtë mënyrë, gjykata paraprakisht duhet të ketë parasysh që të caktojë një dënim që, nga njëra anë, është i aftë të përmbushë qëllimin për të cilin është krijuar ky institut juridik, ndëshkimin, dhe nga ana tjetër, të jetë njëkohësisht i aftë të parandalojë në të ardhmen sjelljet kriminale të të dënuarit dhe ta riedukojë atë.

15. Gjykata për të caktuar llojin dhe masën e dënimit në rastin konkret i referohet edhe nenit 47 të K.Penal që parashikon se “*Gjykata cakton dënimin duke respektuar dispozitat e pjesës së përgjithshme të këtij Kodi dhe kufijtë e dënimeve të parashikuar në ligj për veprën penale. Në caktimin e dënimit ndaj personit ajo merr parasysh rrezikshmërinë e veprës penale, të autorit të saj, shkallën e fajit, si dhe rrethanat lehtësuese dhe rënduese.*” Në këtë dispozitë



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR VLORË

është parashikuar ai që njihet si parimi i individualizimit të dënimit, i cili është një nga parimet themelore që udhëheq gjykatën në caktimin e dënimit. Duke u bazuar në këtë dispozitë le të marrim në trajtim të gjitha kriteret dhe rregullat që duhet të marrë për bazë gjykata për dhënien e llojit dhe masës së dënimit në rastin konkret:

16. Rrezikshmëria e veprës penale: Rrezikshmëria shoqërore e veprës penale përcaktohet në kuadër të objektit të saj si dhe nga tërësia e elementëve objektiv e subjektiv që e formojnë. Pra, përcaktimi i rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale lidhet me natyrën dhe llojin e saj, me masat e dënimit që përcakton neni përkatës, me përhapjen e saj etj. Në këtë kuadër gjykata vëren se vepra penale “Ndërtim i paligjshëm” parashikuar nga neni 199/a/2 të K.Penal parashikohet nga K.Penal si një krim, dhe dënohet me burgim nga një gjer në pesë vjet.

17. Rrezikshmërinë shoqërore e personit (autorit), pra të pandehurit lx. I pandehuri rezulton me gjendje gjyqësore të padënuar, pra nuk ka kryer edhe më parë vepër tjetër penale. Ky fakt, provohet me anë të certifikatës elektronike të administruara në gjykim. Kështu, i pandehuri nuk paraqet rrezikshmëri shoqërore të madhe. Në përcaktimin e rrezikshmërisë shoqërore të personit nga gjykata mbahet parasysh edhe mosha e tij, gjendja shëndetësore, intelektuale e arsimore etj. I pandehuri është në moshë të madhe, kryefamiljar.

18. Shkalla e fajit. Shkalla e fajit të autorit përcaktohet nga faktorë e rrethana të lidhura ngushtë me rrezikshmërinë shoqërore që paraqet vetë personi dhe vepra e kryer prej tij. Në lidhje me këtë kriter, nga tërësia e të gjithë veprimeve të të pandehurit rezulton se ai e ka kryer veprën penale në formën e dashjes së drejtëpërdrejtë.

19. Rrethanat rënduese dhe lehtësuese. Çdo vepër penale kryhet në rrethana të caktuara dhe ka shkaqet e saj, të cilat ndikojnë edhe në rrezikshmërinë shoqërore të veprës, të autorit, duke e shtuar apo pakësuar atë. Bazuar në nenin 49 të K.Penal që përcakton se: “Gjykata, pavarësisht nga rrethanat që përmenden në nenin 48 të këtij kodi, mund të marrë në konsideratë edhe rrethana të tjera që për sa kohë i quan të tilla që justifikojnë lehtësimin e dënimit”, rezulton se lista e rrethanave lehtësues të parashikuara nga neni 48 nuk është shteruese. Në këto kushte, gjykata çmon si rrethanë lehtësues faktin se i pandehuri, nuk kanë kryer më parë ndonjë vepër tjetër penale. Përsa i përket rrethanave rënduese, në rastin konkret nuk rezultoi ndonjë rrethanë rënduese e parashikuar nga neni 49 e K.Penal.

20. Në lidhje me llojin dhe masën e dënimit të të pandehurve, Gjykata pasi ka marrë në trajtim të gjitha kriteret e mësipërme, çmon se ndaj të pandehurit x do të ishte i përshtatshëm aplikimi i dënimit me 1 vit burgim për veprën penale të parashikuar nga neni 199/a/2 të K.Penal. Dënimi është në përputhje me rrethanat e çështjes dhe qëllimin riedukues e parandalues (të posaçëm e të përgjithshëm) të dënimit penal. Duke qenë se në gjykimin e kësaj çështjeje është proceduar me gjykim të shkurtuar, në zbatim të nenit 406/1 të K.Pr.Penale, i cili parashikon: “1. Kur jep vendim dënimi, gjykata e ul dënimin me burgim ose gjobë me një të tretën...” gjykata vendosi dënimin e të pandehurit përfundimisht me 8 muaj burgim.

21. Neni 59 i Kodit Penal parashikon se “1. Për shkak të rrezikshmërisë së pakët të personit, moshës, kushteve shëndetësore apo mendore, mënyrës së jetesës dhe të nevojave veçanërisht atyre që lidhen me familjen, shkollimin ose punën, rrethanave të kryerjes së veprës penale, si dhe të sjelljes pas kryerjes së veprës penale, gjykata, kur jep dënim me burg deri në pesë vjet, mund të urdhërojë që i dënuari të mbajë kontakte me shërbimin e provës dhe të vihet në provë, duke pezulluar ekzekutimin e dënimit, me kusht që gjatë kohës së provës të mos kryejë vepër tjetër penale. 2. Për dënimet e dhëna deri dy vjet burgim të pezulluara nga gjykata, afati i provës është sa dyfishi i kohës së dënimit të dhënë me burgim të dhënë nga gjykata”. Gjykata, vlerëson se, për shkak të rrezikshmërisë së pakët të të



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR VLORË

pandehurit, dënimi me burgim duhet të pezullohet dhe i pandehuri duhet të vihet në provë për një periudhë kohe prej 16 (gjashtëmbëdhjetë) muaj.

22. Përsa i përket shpenzimeve procedurale, bazuar në nenin 393 paragrafi 1 dhe në nenin 485 të K.Pr.Penale, shpenzimet procedurale të fazës së hetimit si dhe shpenzimet gjyqësore i ngarkohen të pandehurit.

Përfundimisht, gjykata;

[1] Në nenin 92 pika 2 të Ligjit Nr. 10 119 datë 23 Prill 2009 "Për planifikimin e territorit", nën titullin "Fillimi i efekteve të plota të ligjit dhe shfuqizimi i ligjit ekzistues", thuhet shprehimisht se: "...3. Ligji nr. 8405, datë 16.9.1998 "Për urbanistikën", i ndryshuar, shfuqizohet në tërësi në datën 30 shtator 2011."

Për keto arsye:

Baza Ligjore:

Gjykata, bazuar në nenin 379, 384, 390, 406 e 485 të Kodit të Procedurës Penale, neni 47, 48, 49, 59, të Kodit Penal, Vendimit Unifikues nr. 2, datë 29.01.2003 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, <?xml:namespace prefix = "o" ns = "urn:schemas-microsoft-com:office:office" />



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR VLORË

VENDOSI:<?xml:namespace prefix = "o" ns = "urn:schemas-microsoft-com:office:office" />

1. Deklarimin fajtor të të pandehurit x , për kryerjen e veprës penale “*Ndërtim i paligjshëm*”, parashikuar nga neni 199/a/2 i Kodit Penal
2. Dënimin e shtetasit x me 1 (një) vit burgim.
3. Në aplikim të nenit 406 pika 1 të Kodit të Procedurës Penale zbritet 1/3 e dënimit, duke e dënuar përfundimisht shtetasin x me 8 (tetë) muaj burgim.
4. Në aplikim të nenit 59 të K.Penal, urdhërohet pezullimi i ekzekutimit të dënimit me burgim ndaj x , duke e vënë në provë të pandehurin për një periudhë kohe prej 16 (gjashtëmbëdhjetë) muaj, me kusht që gjatë kësaj kohe i pandehuri të mos kryejë veprë tjetër penale dhe të mbajë kontakte me Shërbimin e Provës.
5. Në zbatim të nenit 61 të Kodit Penal, detyrohet i pandehuri x që gjatë kohës së provës:
 1. *T’i përgjigjet thirrjeve dhe kërkesave të Zyrës Vendore të Shërbimit të Provës Vlorë, duke marrë në vlerësim kjo e fundit në hartimin e programit të mbikqyrjes rrethanat lidhur me punësimin e të pandehurit dhe rrethanat familjare të të pandehurit;*
 2. *Të marrë pëlqimin në Zyrën Vendore të Shërbimit të Provës Vlorë për ndryshimin e vendbanimit.*
6. Një kopje e këtij vendimi t’i dërgohet Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Vlorë dhe Zyrës Vendore të Shërbimit të Provës Vlorë për të kontrolluar verifikuar respektimin e detyrimeve të dhena me këtë vendim nga ana e gjykatës.
7. Shpenzimet proceduriale hetimore në shumën 250 lekë të parapaguara nga shteti t’i lihen në ngarkim të të pandehurit.
8. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën e Apelit Vlorë brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve duke filluar ky afat nga dita e nesërme e shpalljes së këtij vendimi.

U shpall sot, në Vlorë, më datë 29.09.2017!

Ky dokument është marrë nga www.gjykata.gov.al. Ai ka vlerë të plotë informuese, por nuk shërben si dokument zyrtar. Ky i fundit lëshohet nga autoritetet përkatëse.